



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ministri

2510
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 10.4.2014.

UDHËZIM

Nr. 12, datë 10.4.2014

PËR

**“PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË
(PROVIME TË LIRIMIT) 2014”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 50 të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 1013, dt. 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, VKM nr. 67, dt. 10.02.2013 “Për krijimin e IZHA”, VKM Nr. 352, dt. 03.04.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit”

UDHËZOJ

1. Lëndët dhe datat e Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë (Provime të Lirimit) janë:
 - a) Gjuhë shqipe 23 qershor 2014
 - b) Matematikë 27 qershor 2014
2. Nxënësit e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) zhvillojnë edhe Provimin e Lirimit në lëndën gjuhë amtare. Provimi i Lirimit në lëndën gjuhë amtare, do të zhvillohet më datën 20 qershor 2014.
3. Provimet e lirimit 2014, të fillojnë në orën 10.00 dhe të zgjasin 2 orë e 30 minuta.

4. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në Rregulloren për "Procesin e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë (provime të lirimit) 2014".
5. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën gjuhë amtare, përgatitet nga DAR Gjirokastër. Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë, tërheqin në DAR Gjirokastër tezën ditën e provimit.
6. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën gjuhë amtare, përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.
7. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.
8. Për institutin e nxënësve që nuk shikojnë, testi të tërhiqet në AKP nga drejtorja e institutit, një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit brail.
9. Nxënësi mbetës në provimet e lirimit ka të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë.
10. Inspektorati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e Provimeve të Lirimit dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.
11. Arkivimi i testeve të bëhet pranë DAR/ZA-ve qendra.
12. Sektori i Statistikës i DAR/ ZA-së merr nga QVT-ja dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet e lirimit. Këto të dhëna dërgohen në AKP, ISHA dhe MAS.
13. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Shërbimeve të Brendshme, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare"

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

